

Tiranë, 26 Qershor 2020

- Drejtuar:** Znj. Fjoralba Caka, Zv/Ministër, Ministria e Drejtësisë
Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Znj. Jonida Gaba, Drejtoreshë Kabineti, Ministria e Drejtësisë
Z. Rudolf Papa, Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
Znj. Erjona Hoxhaj, Drejtoreshë Kabineti, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Z. Besmir Beja, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, Ministria e Drejtësisë
- Për dijeni:** Znj. Vasilika Hysi, Zëvendëskryetare e Kuvendit dhe Kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut
Z. Mario Mariani, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
Shkëlqesia e Saj, Znj. Yuri Kim, Ambasadore e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri
Shkëlqesia e Tij Z. Adrian Maître, Ambasador i Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri
Shkëlqesia e Tij Z. Duncan Norman, Ambasador i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri
Shkëlqesia e Saj Znj. Elsa Håstad, Ambasadore e Ambasadës Suedeze në Shqipëri
Shkëlqesia e Saj Znj. Guusje Korthals Altes, Ambasadore e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri
Znj. Jutta Gützkow, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri
Z. Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv, Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile
Z. Blendi Dibra, Nënkryetar i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile
Z. Elvis Koçi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
- Subjekti:** Letër e hapur në përgjigje të shpalljes për konsultim publik të projektligjit “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, më datë 10.06.2020

Ne, një grup organizatash të shoqërisë civile, jemi bërë me dije mbi projekt ligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, përmes shpalljes për konsultim publik në

Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, më datë 10.06.2020.

Vlerësojmë pozitivisht iniciativën për rishikimin e Ligjit për Regjistrimin e OJFve, për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe efçente për OJFtë dhe krijimin e regjistrit elektronik me qëllim lehtësimin e procedurave dhe uljen e kostove të regjistrimit, ndryshimeve në regjistrim apo ç' regjistrimit të tyre, mbajtjen e të dhënave të sakta për sektorin dhe rritjen e transparencës lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e OJFve.

Megjithatë, projektligji duket shumë problematik dhe përmban dispozita të paqarta dhe të sfumuara që mund të prekin lirinë e organizimit dhe të tkurrin veprimtarinë e sektorit.

Në projektligjin e propozuar vërehet si një zhvillim pozitiv për legjislacionin fakti që synon të ulë barrën dhe koston e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, ndryshimeve në regjistrim apo ç' regjistrimit të tyre pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Megjithatë, ajo që bie fillimisht në sy nga relacioni shoqërues i projektligjit është fakti që nuk përmendet marrja si referencë e asnjë modeli apo modeleve ligjesh të ngjashme të vendeve të Bashkimit Evropian në hartimin e tij.

Në projektligj përmenden rekomandimet e MONEYVAL i cili për shkak të specifikave dhe fushës që mbulon ka evidentuar disa çështje që kanë të bëjnë me parandalimin e financimit nga terrorizmi në sektorin e OJF-ve, por në vlerësimin tonë, këto rekomandime kryesisht i referohen politikave të vendit (pra jo detyrimisht kërkohen ndryshime të natyrës legjislative) dhe jo detyrimisht duhet të sjellin ndryshimin e një ligji të tërë dhe as nuk mund të përgjithësohen për çdo aspekt të regjistrimit të organizatave. Në të kundërt mund të krijojnë pengesa apo problematika dhe mund të krijojnë premisa për cënimin e lirisë së organizimit kolektiv të parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës.

E drejta dhe liria e organizimit është e garantuar në akte ndërkombëtare ku vendi ynë ka aderuar sikurse është neni 20 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 22 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 11 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Të gjitha këto instrumenta ndërkombëtare e kanë konsideruar të drejtën e organizimit si një të drejtë njerëzore individuale, të cilën njerëzit që e gëzojnë këtë të drejtë i krijon mundësinë të bashkohen dhe kolektivisht të ndjekin, promovojnë dhe mbrojnë interesin e tyre të përbashkët. E drejta e organizimit përfshin të drejtën për të themeluar një organizatë, për t'ju bashkuar një organizate ekzistuese dhe hapësirën që kjo organizatë të ushtrojë funksionet e saj pa ndërhyrje të paligjshme nga shteti apo individë të tjerë. Shtetet kanë detyrimin të respektojnë, mbrojnë dhe lehtësojnë lirinë e organizimit, të mos ndërhyjnë, përfshi këtu vendosjen e kufizimeve në mënyrën se si ushtrohet kjo e drejtë dhe se si performojnë organizatat.

Statusi ligjor i OJF-ve është gjithashtu objekt rregullimi i dy instrumentave jo të detyrueshëm por të rekomandueshëm të Këshillit të Evropës, përkatësisht Parimet themelore për statusin e organizatave jofitimprurëse në Evropë i vitit 2002 dhe Rekomandimi nr.14 i Komitetit të

Ministrave i vitit 2007 për vendet anëtare për statusin ligjor të organizatave në Evropë. Të dy dokumentet përmbajnë një kuadër gjithëpërfshirës rregullator që duhet të shërbejë si standard minimum për të udhëhequr vendet anëtare të Këshillit të Evropës në hartimin e legjislacionit, politikave dhe praktikave ndaj OJF-ve.

Lidhur me lirinë e organizimit ka gjithashtu një jurisprudencë të gjerë në nivel ndërkombëtar, sikurse janë organet kuazi gjyqësore veçanërisht Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Kjo jurisprudencë, trajton disa çështje që kanë të bëjnë me lirinë sindikaliste por gjithashtu ka qartësuar shtrirjen dhe kufizimet në lirinë e organizimit të OJF-ve. Gjithashtu edhe Komisioni i Venecias ka shprehur opinione lidhur me lirinë e organizimit duke marrë në analizë legjislacionin përkatës të vendeve përkatëse sikurse është rasti i Azerbajxhanit dhe në opinionin përkatës të vitit 2014 janë gjetur disa shkelje të standarteve ndërkombëtare <https://rm.coe.int/1680306ff8>. Në këtë opinion, Komisioni i Venecias ka konstatuar se ndryshimet e propozuara në legjislacionin e Azerbajxhanit kanë një efekt tkurrës në veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse (chilling effect) dhe se diskrecioni i mbikqyrjes nga autoritetet publike është jo i kufizuar ose është përcaktuar në mënyrë jo të qartë. Komisioni i Venecias nënvizon se regjistrimi nuk duhet të jetë një kusht thelbësor për ekzistencën e organizatës, pasi kjo do të lejonte autoriteteve vendase të ushtronin kontroll mbi thelbin dhe ushtrimin e të drejtës dhe lirisë së organizimit.

Sa më sipër, në aspektin parimor të përgjithshëm do të sugjerohet që në relacionin shoqëruar të projektligjit të vendoset një seksion i veçantë ku të analizohet pajtueshmëria e dispozitave të tij me Konventat ndërkombëtare, Rekomandimet e Këshillit të Evropës, udhëzuesin e përbashkët të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR (të vitit 2019) por në mënyrë të veçantë me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka gjetur në jo pak raste probleme strukturore në legjislacionin e vendeve anëtare të KE sa i takon pajtueshmërisë së tyre me Konventën Evropiane.

Në pikën VIII të relacionit shoqëruar të projektligjit përmenden personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit. Por me shqetësim vërehet se në këtë grup personash (fizikë/juridikë) nuk përmenden organizatat e shoqërisë civile.

Ministria e Drejtësisë duhet ti kishte kushtuar një vëmendje shumë të veçantë përfshirjes së OJF që në fazat e para të hartimit të kësaj nisme. Sipas Rekomandimit të vitit 2007 (nr.14) të Komitetit të Ministrave mbi statusin ligjor të organizatave jofitimprurëse në Evropë, OJF-të duhet të konsulohen gjatë hartimit të legjislacionit parësor dhe dytësor që ndikon në statusin, financimin e tyre apo në sferën e veprimtarisë. Sigurimi i efikasitetit në procesin e konsultimit kërkon që ky proces të jetë përfshirës dhe të mundësojë pjesëmarrjen e grupeve të interesit që përfaqësojnë pikëpamje të ndryshme apo opozitare në ligjëbërje.

Projekt ligji sjell disa ndryshime të cilat përbëjnë shqetësim për organizatat e shoqërisë civile, si dhe paqartësi të cilat është e nevojshme të bëhen më të qarta me qëllim funksionimin më të mirë të ligjit.

Bashkangjitur po paraqesim dy dokumente rezultat i diskutimit dhe dhënies së sugjerimeve nga organizatat e përfshira në këtë proces konsultimi (si më poshtë lista e organizatave firmëtare):

1. Dokumentin me propozime parimore për dispozitat e projekt ligjit;
2. Dokumentin e Projekt Ligjit me disa konsiderata e sugjerime nen për nen.

Duke konsideruar sa më lart, në emër të grupimit të organizatave firmëtare, kërkojmë:

- Marrjen në shqyrtim të sugjerimeve tona dhe rishikimin e draft projekt ligjit për adresimin e çështjeve shqetësuese që janë ngritur si dhe sqarimin e çështjeve të paqarta në projekt ligj;
- Duke vlerësuar rëndësinë e këtij draft ligji dhe impaktin që do të ketë në sektor vlerësojmë se është e nevojshme një takim konsultues midis sektorit dhe institucioneve të përfshira në hartimin dhe zbatimin e këtij projekt ligji.

Për çdo komunikim të mëtejshëm lidhur me sugjerimet dhe kërkesat tona, në emër të grupit propozues pika e kontaktit për këtë çështje është Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në adresën e email info@resourcecentre.al ose numër tel: 04 2 254881.

Duke Ju falenderuar paraprakisht për marrjen në konsideratë të kërkesës sonë,

Me respekt,

(sipas rendit alfabetik)

Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Dorcas Aid International Albania

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Forumi Civil Selenicë

Instituti Për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Instituti për Kontratën Shoqërore

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lëvizja Evropiane në Shqipëri

Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”

Organizata “Udhëtim i Lirë”

Organizata “Unë Gruaja”

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Qendra “Epoka E Re”

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Qendra Burimore e Mjedisit, Shqipëri (REC Albania)

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Qendra Psiko-Sociale “Vatra”

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Roma Active Albania

Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri - Birn Albania

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Shoqata “Përtej Barrierave”

Terre Des Hommes, Albania

World Vision Albania